

VEÇORITË E KOMUNITETIT MISIONALE

Nga TODD MORR



WWW.MISSIONALMADESIMPLE.COM

VIZIONI:

Ungjilli. Komuniteti si familje. Misioni.

Në gjithçka që bëni si KM le të jenë vlerat e Ungjillit, Familjes dhe Misionit udhëzuesit për pyetjet "pse", "çfarë", "ku" dhe "si".

MADHËSIA E GRUPIT:

- 6-14 të rritur + jo të krishterë. Kur grupi arrin një numër prej 12-14 të rriturish, atëherë po shkon drejt shumëfishimit, veçanërisht nëse ka një numër të konsiderueshëm fëmijësh të përfshirë.
- Nëse numri është më i vogël, atëherë nuk përbën tamam një komunitet.
- Nëse numri është më i madh, mund të kthehet në një komunitet të pamenaxhueshëm.
- Një grup thelbësor prej 4-8 vetësh, që marrin përgjegjësi për jetën në komunitet.

DINAMIKAT E MARRËDHËNIEVE:

3 lloje ose shtresa marrëdhëniesh - Grupi bërthamë, të krishterë të rinj, jo të krishterë.

Kjo do të thotë që rreth 4-8 vetë përbëjnë grupin bërthamë, 4-8 të krishterë të rinj rreth grupit bërthamë dhe 10-15 jo-të krishterë në mënyrë që KM të ndiejë thirrjen për të dashur dhe ndikuar përmes Ungjillit. Ky është fokusi i misionit të tyre.

AFËRSIA:

Në mënyrë ideale, çdokush në KM, që jeton 10-15 minuta larg me makinë ose transport publik. Në qytete të mëdha dhe të zhurmshme, me trafik të rënduar dhe distancë të largët, mund t'ju duhet të përshtateni. Megjithatë, punoni fort drejt afërsisë ose lidhjeve të ngushta. Nëse njerëzit nuk jetojnë afër njëri-tjetrit, është e vështirë që të jetojnë jetë normale ose spontane së bashku.

Nëse ka lidhje të ngushta, ku një pjesë e mirë e gjërave bëhen së bashku dhe ka përshtatje në raporte dhe plane, atëherë një KM i tillë mund të funksionojë si një Familje e frytshme në Mision. Lidhje të ngushta mund të formojnë një grup muzikantësh, një grup që bën ushtrime fizike, palestër së bashku, një grup mjekësh dhe infermierësh në të njëjtin spital, ose një grup familjesh në të njëjtën shkollë apo skuadrën e sportit të të rinjve.

KOHËZGJATJA DHE PËRKUSHTIMI:

KM-të zakonisht organizohen për një vit dhe i përkushtohen njëri-tjetrit e të jetuarit së bashku.

Në fund të vitit të parë, zakonisht grupet nuk shpërndahen, por shtohen, rigrupohen apo reformohen në ndonjë mënyrë. Përkushtimi 1 vjetor është si një cikël normal i jetës, pas kësaj vjen një kohë tërheqjeje për të vlerësuar, përshtatur, marrë dhe dhënë mendime në mënyrë që viti i ardhshëm të nisë me një vizion ripërtëritës.



SHPESHTËSIA:

Një javë e zakonshme përfshin 4 ose 5 kontakte, të cilët i takoni në kohë dhe mënyra të ndryshme. Ndonjëherë mund të ndodhë të takoni pak njerëz, herë të tjera të takoni më shumë. Disa gjëra mund të jenë të përshtatshme vetëm për femra, disa të tjera vetëm për meshkuj. KM jeton së bashku, kjo do të thotë të zhvillosh aktivitete, të cilat do të ndodhin në raporte të ndryshme, në kohë dhe vende të ndryshme. Këto "kontakte" mund të duken si më poshtë dhe mund t'ju ndihmojnë me ide të tjera:

- Takimet e së dielës
- KM, darkat familjare
- Grupe DNA për burra dhe gra
- Familje, që ftojnë për darkë beqarë ose çifte të tjera
- Drekë ose darkë duke përgatitur ushqim në skarë me 2 çifte të KM-së dhe 2 çifte jo të krishterësh, që mund të jenë kolegë ose fqinjë
- Të shkosh në park ose për ngjitje në mal me disa ose të gjithë anëtarët e KM-së së bashku dhe me miq jo të krishterë
- Të shkosh për vrap, ecje, xhiro me biçikletë ose palestër me disa nga KM-ja dhe të tjerë
- Të kujdesesh për fëmijët e dikujt
- Mbrëmje lojërash ose një film me disa ose të gjithë KM-n
- Të sigurosh një vakt të gatuar ose ushqime për një familje, që është sëmurë, ose sapo janë bërë me fëmijë apo kanë humbur punën
- Të dërgosh vazhdimisht mesazhe përkujdesi dhe të inkurajosh dikë, Grupë DNA-in tënd ose gjithë KM-në

PLANIFIKIM:

Krijoni një plan të përgjithshëm për vitin, por më vonë krijoni një plan specifik 30-ditor për të cilin ruaj komunikim të vazhdueshëm. (Si shembull referoju "Plani 30 ditor i KM-së")

Rishikojë planin 30-ditor kur të jetë e nevojshme në mënyrë që të marrësh në konsideratë një sezon të vitit apo të jetës. Sezonet ndikojnë te mundësitë dhe gatishmëritë, ndaj mund të krijojnë shanse të reja misioni, që lidhen me pushimet, fillimin e vitit shkollor apo të vitit të ri, etj.

FOKUSI I MISIONIT:

Kalo kohë me anëtarët e përhershëm të KM-së dhe shkruaj emrat e gjithë jo të krishterëve, me të cilët Zoti ka drejtuar çdo anëtar që të krijojë marrëdhënie; nga lagjja, puna, shkolla, aktivitetet shkollore, aktivitetet për fëmijë, pasionet, etj. Do të shohësh që kjo do të duket si një "pishinë" me të paktën 40-60 njerëz. Më vonë, nga ajo "pishinë" e madhe njerëzish, lutu dhe dallo afërsisht 10-15 veta, të cilët janë "tokë e mirë". "Tokë e mirë" janë ata, që janë të hapur për biseda, marrëdhënie dhe njohje të botës shpirtërore. Këta janë njerëzit që Shpirti vazhdon t'i sjellë në mendjen dhe zemrën tënde. Këta 10-15 njerëz pra, janë Fokusi i Misionit rreth të cilëve KM-ja juaj ka vendosur përparësi që t'i dojë dhe t'u gjendet afër. (Shiko gjithashtu 5 Vetitë Themelore për Mision Efektiv)



FAKTORË TË TJERË:

- 1. Shumë breza: Të kesh një KM** me breza të ndryshëm, se sa të ndarë sipas moshës, mund të ketë një efekt të madh në maturinë shpirtërore të njerëzve. Ka shumë gjëra, të cilat çdo brez ka nevojë t'i përjetojë, sikurse edhe të inkurajohet nga breza të tjerë.
- 2. Drejtim i përbashkët i grupit bërthamë:** Merr në konsideratë talentet, personalitetin, pjekurinë dhe përvojën e çdo personi. Përdor talentet e çdokujt, pasionet dhe perspektivën. Është thelbësore për çdo KM të udhëhiqet nga një grup njerëzish, se sa nga 1 ose 2 individë. Me një grup bërthamë të konsoliduar ka më shumë fuqi, kapacitet, diversitet dhe ndikim të përbashkët. Me një grup që drejtojnë së bashku, çdo aspekt i jetës në komunitet do të jetë më efektiv dhe i qëndrueshëm. Kjo përfshin mikpritje, ndihmë në takime dhe evente, mësimdhënie, pastorim, komunikim dhe planifikim.
- 3. Komunikim:** Kërko mendim dhe vendos cila formë komunikimi është më efektive dhe më e lehtë për grupin tuaj, ku ata mund të lexojnë dhe të përgjigjen. Mund të jetë Facebook, email, mesazhe apo aplikacione, që përdoren për komunikim në grup. Merr në konsideratë caktimin e një personi nga grupi bërthamë si përgjegjës për komunikim javor me të gjithë KM-në për disa muaj e në vazhdim. Në kultura, të cilat ka një ritëm të shpejtë të jetës dhe janë të mbingarkuara me informacion është thelbësore të dërgosh vazhdimisht mesazhe rikujtese.
- 4. Fëmijët e vegjël:** Prindërimi së bashku në një KM është një përvojë e jashtëzakonshme, sepse ndikimi i shumë të rriturve ndihmon për të krijuar modele të mira marrëdhëniesh dhe pjekurie shpirtërore te fëmijët. Një komunitet, që jeton si një familje së bashku dhe në mision është në gjendje të modelojë dashuri, përkujdes, zemërgjerësi, mikpritje dhe shumë aspekte të tjera të Ungjillit të gjallë. Duhet një komunitet dishepujsh që të ndihmojë t'i rrisim fëmijët tanë si dishepuj të pjekur!
- 5. Adoleshentët:** Kjo varet nga kisha, nëse ka apo jo një grup të rinjsh dhe ç'lloj grupi ka. Nëse ka një grup të rinjsh të konsoliduar, kjo do ta plotësojë përvojën e një adoleshenti në një KM. Nëse grupi i të rinjve është shumë i vogël ose jo i konsoliduar, atëherë KM-ja mund të kërkojë mënyra se si të sigurojë përvojë shpirtërore për adoleshentët e tyre. Kjo mund të ndodhë përmes një DNA-i Mentorimi, që nënkupton 3 ose 4 takime të rinjsh me një mentor të rritur. Evente të tjera sociale mund të shtohen që të përmbushin nevojat e tyre miqësore përgjatë fazave unike të adoleshencës. Adoleshentët duhet të kuptojnë që tashmë ata janë kisha dhe që kanë vlera. Ata duhet të shihen si pjesë e KM-së po aq sa çdo i rritur aty. Ashtu si me fëmijët e vegjël, ndikimi i të rriturve të ndryshëm nga KM-ja në jetët e tyre mund të jetë i jashtëzakonshëm.
- 6. Alternim nëpër shtëpi:** Një pjesë e realitetit këtu është se komuniteti duhet të funksionojë si një familje e mirë. Kjo do të thotë që, kushdo që ka hapësirë të mjaftueshme në shtëpitë e tyre, duhet të ndihmojë duke ftuar njerëz për një vakt, festë apo aktivitete. Kjo është shumë e rëndësishme në mënyrë që të parandalojë rraskapitjen për shkak të mikpritjes. Një pjesë e qëllimit është të ndihmosh çdo person apo çift të zhvillojë aftësinë e mikpritjes, e cila është një cilësi e rëndësishme e një dishepulli të pjekur.



7. **Vakte dhe ushqim:** Ji krijues dhe i gatshëm për t'u përshtatur. Në disa raste mund të jetë një vakt i vogël dhe i thjeshtë. Në raste të tjera argëtohu duke përgatitur një vakt të bollshëm, udhqim të mirë, që bëhet fokusi i mbrëmjes. Sërish, jini një familje e mirë në mënyrën se si organizoheni, përgatiteni dhe i përjetoni të tilla mbrëmje apo dreka në një MC. Çdokush duhet të kontribuojë dhe ndihmojë. Sigurohuni që secili të ndihmojë për të pastruar së bashku në fund. Në rastet kur keni një numër të madh fëmijësh, duhet ta mendoni mirë se si do t'i ushqeni dhe t'i mbani të pastër në mënyrë që kjo gjë të mos dominojë mbrëmjen.

